



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 665 Prot.

Tiranë, më 30 . 04 . 2024

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për përfitimin e kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për të gjitha familjet me të ardhura më të ulëta se 35.000 lekë në muaj dhe jo vetëm të familjeve me kryefamiljarë, punonjës buxhetorë, në VKM-në me nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike, deri në 300 Kwh”.

KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Rruga e Kavajës

Tiranë

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISË

Rr. “Abdi Toptani”, Nr.1, 1001, Tiranë

MINISTRISË SË FINANCAVE

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3, Tiranë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar², si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi, si dhe nga çdo formë sjelljeje që e nxit atë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja “F”, të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), përcaktohet se:

“Komisioneri ka kompetencë ... të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”.

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja “c”, të LMD-së, ku përcaktohet se:

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

“Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”, Komisioneri, në ushtrim të kompetencës që i jep LMD, me Urdhër nr. 61, datë 30.03.2022³, ka filluar procedurat ndjekjen kryesisht të çështjes mbi kompensimin e energjisë elektrike për kategorinë e parashikuar në shkronjën ç, të pikës 1, të VKM nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike, deri në 300 Kwh”.

I. Parashtrimi i fakteve lidhur me problematikën e marrë në shqyrtim.

Me anë të Vendimit nr. 8, datë 14.01.2015 *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike, deri në 300 Kwh”,* Këshilli i Ministrave ka vendosur të kompensojë diferencën e çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 KWH në muaj, për të mbrojtur disa kategori të shtresave në nevojë.

Në pikën 1, shkronja ç, të kësaj VKM-je, përfshihen si kategori përfituese, familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar.

Sa më sipër, rezulton se ky parashikim i kësaj dispozite, vendos një diferencë në trajtim, midis familjeve të punonjësve buxhetorë, me pagë mujore bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar, dhe familjeve të cilat ndodhen në kushte të ngjashme, pra kanë të punësuar vetëm kryefamiljarin, me pagë mujore bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar, me ndryshimin e vetëm se, kryefamiljari, është i punësuar në sektorin privat.

Nisur nga sa më sipër, në pamje të parë, evidentohet se, nëse kategoria e familjeve të punonjësve buxhetorë, me pagë bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar, përfiton kompensim të energjisë elektrike për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh, sipas pikës 1/ç, të VKM nr. 8/2015; kategoria e familjeve të punonjësve të punësuar në sektorin privat, me të njëjtin nivel page dhe në të njëjtat kushte, ku i vetmi i punësuar i familjes është kryefamiljari, nuk përfiton nga skema e mbrojtjes së shtresave në nevojë, parashikuar nga VKM-ja sipërcituar.

³ Urdhër nr. 61, datë 30.03.2022 *“Për fillimin e procedurave për ndjekjen “ex officio” të çështjes mbi kompensimin e energjisë elektrike për kategorinë e parashikuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të VKM nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH.”*”.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në lidhje me problematikën e evidentuar, sa i takon parashikimit të bërë në pikën 1/ç, të VKM-së me nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike, deri në 300 Kwh”, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 541/1 prot., datë 12.04.2022, ka kërkuar nga ana e Këshillit të Ministrave informacionin e mëposhtëm:
 - “Cili është qëllimi i synuar i skemës së mbrojtjes sociale të parashikuar sipas VKM-së nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike, deri në 300 Kwh”?”
 - Cilat janë arsyet që VKM-ja sipërcituar, nuk ka përfshirë si kategori përfituese familjet e të punësuarve në sektorin privat, me pagë mujore bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë) mijë lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar?
 - Çdo informacion që gjykohet i arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.”
2. Në mungesë të dërgimit të informacionit, sipërcituar Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 541/4 prot., datë 10.06.2023, iu drejtua sërish Këshillit të Ministrave, duke kërkuar të njihet me parashtrimet dhe qëndrimin e KM-së, për problematikën e evidentuar.
 - Lidhur me sa mësipër, Komisionerit nuk iu vu në dispozicion asnjë parashtrim apo informacion nga ana e KM-së, lidhur me sa është kërkuar prej tij, lidhur me çështjen objekt të procedurës hetimore, të nisur kryesisht nga KMD.

III. Legjislacioni i zbatueshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.
2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 16

1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejné njëloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.
2. Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve.

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojné thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojné kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligjje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 59

Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

- a) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;
- b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;
- c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;
- ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë;
- d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
- dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;
- e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;
- ë) zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse;
- f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paafteve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;

g) mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

Neni 122

1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. 33

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Neni 2

Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër.

Neni 7

Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë.

Neni 25

Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili t'i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut⁴ (KEDNJ)

Neni 14

“Ndalimi i diskriminimit”

⁴ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindaj ose çdo status tjetër.

Protokolli 12, KEDNJ

Neni 1

“Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit”

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore⁵.

Neni 10

Shtetet palë të këtij Pakti pranojnë se:

1. Një mbrojtje dhe ndihmë sa më e gjerë duhet t'i jepen familjes, e cila është element i natyrshëm dhe themelor i shoqërisë, sidomos për formimin e saj dhe për aq kohë sa ajo ka përgjegjësinë për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve në ngarkim. Martesa duhet të bëhet me pëlqimin e lirë të bashkëshortëve të ardhshëm.

Neni 11

1. Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për një standard adekuat të jetesës për vete dhe për familjen e tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin adekuat si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës. Shtetet palë do të marrin masa të përshtatshme për të siguruar realizimin e kësaj të drejte, duke njohur për këtë qëllim rëndësinë thelbësore të një bashkëpunimi ndërkombëtar të pranuar lirisht.

Karta Social Europiane (e rishikuar), (1996).

Neni E, në Pjesën V

⁵ Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, ka hyrë në fuqi në më 3 janar 1976.

Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakut të tillë si race, ngjyre, seksi, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjinë shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindje ose statusi tjetër.

Direktiva 2009/72/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Evropës lidhur me rregullat e përbashkëta për tregjet e brendshme të energjisë elektrike

Neni

7

Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate për të mbrojtur konsumatorët dhe do të sigurojnë marrjen e masave adekuate mbrojtëse për të mbrojtur konsumatorët e cënueshëm. Në këtë kontekst, çdo shtet anëtar do të definojë konceptin e konsumatorëve të cënueshëm, i cili do t'i referohet varfërisë dhe midis të tjerave duhet të ndalojë ndërprerjen e energjisë elektrike për konsumatorët në raste kritike.

Neni 8

Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate sikundër janë formulimi i planeve kombëtare të veprimit për energjinë, që sjell përfitime në sistemin e sigurimit social dhe për të siguruar furnizimin e nevojshëm të energjisë për konsumatorët e cënueshëm apo ofrimin e përkrahjes për përmirësimin e efikasitetit të energjisë....

Ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”

Neni 1

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e sigurimit, të shpërndarjes, të administrimit dhe të planifikimit të programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballeshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit.

2. Ky ligj e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Në zbatim të këtij ligji, termit e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1."Strehim" është tërësia e elementeve financiare, sociale dhe institucionale të procesit të sigurimit të banesës.

....

25.“Të ardhura familjare” janë të ardhurat periodike që siguron familja nga pagat, veprimtaria ekonomike, ndihma ekonomike dhe pagesa e papunësisë, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes

me aftësi të kufizuara dhe përfitimet e invalidëve, sipas statusit të invalidit të punës apo të luftës, interesat e depozitave bankare, të ardhura nga persona të tretë, qiratë nga prona të paluajtshme. Në këto të ardhura nuk përfshihen ato nga rimbursimi i shpenzimeve për energji, rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë, paketa higjieno - shëndetësore për PAK-të, pagesa për kujdestarin për PAK-të, kur ky/kjo nuk është anëtar i familjes.

Koncepti “strehim i përshtatshëm”, duhet të garantojë jetën private, një jetesë të sigurtë, të qetë dhe me dinjitet. Si një nga kushtet thelbësore sipas këtij ligji për një strehim të përshtatshëm është qasja “*në shërbimet publike, si: furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve*”.

Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektike”

Neni 95

“Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë, Ministrinë e Financave, dhe në konsultim me ERE-n e grupet e interesit, harton kriteret, procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret për përfitimin e statusit të klientit në nevojë marrin në konsideratë: a) klientët me të ardhura të ulëta, të cilët përdorin energjinë elektrike për furnizimin e vendbanimit të tyre të përhershëm. Klientët në nevojë, që përfitojnë mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit, regjistrohen në një regjistër të veçantë nga struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për mirëqenien sociale. Ky informacion i dërgohet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesit të energjisë elektrike. Klientët në nevojë, që përfitojnë mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit, duhet të përdorin fondet e përfituara për të paguar detyrimet e energjisë elektrike. Financimi për mbështetje të klientëve në nevojë duhet të bëhet në mënyrë jodiskriminuese, duke mos lejuar ndërfinancimin nga kategoritë e tjera të klientëve të energjisë elektrike. Mbi bazën e të dhënave të përcjella, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesi krijojnë dhe ruajnë një regjistër të të dhënave të klientëve në nevojë. Të dhënat e regjistrit mund t’i vihen në dispozicion klientit në nevojë, në çdo kohë që kërkohen nga ky i fundit”.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar

Neni 1

“Objekti”

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore,

predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër

Neni 2

“Qëllimi”

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Neni 3

“Përkufizimet”

“*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

“*Diskriminim i drejtpërdrejtë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

“*Diskriminim i tërthortë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

Neni 20

“Të mirat dhe shërbimet”

1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar

të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

Neni 22

“Statusi”

Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 32

“Kompetencat”

1.Komisioneri ka kompetencë:

...c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;

...ë) t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”.

“Këshilli i Ministrave, vendosi:

1. Kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj, për:

.....

c) familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë) mijë lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar...”

Udhëzim nr. 1, datë 02.02.2015 i MF-së, MEI dhe MMSR “Mbi zbatimin e VKM nr. 8, datë 14.01.2015 për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 Kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Ky Udhëzim përcakton, ndër të tjera se:

“Përfitojnë kompensim për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj: kategoritë e përcaktuara në pikën 1, germat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të vendimit nr. 8, datë 14.1.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”.

Fatura e energjisë elektrike për përfituesit e këtij kompensimi do të jetë e njëjtë me faturën e konsumatorëve që nuk e përfitojnë këtë kompensim dhe vlera e saj do të shprehet me çmimin e ri të energjisë elektrike.

Kompensimi për të përballuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike, si rezultat i heqjes së fashës deri në 300 Kwh bëhet vetëm për një kontratë të energjisë elektrike dhe vetëm për një prej kategorive përfituese të përcaktuara në pikën 1 të vendimit.

III. Kryefamiljarët që janë punonjës buxhetorë, me pagë mujore bruto nën 35 000 lekë në muaj.

1. Përcaktimi i përfituesve do të bëhet nga insitucionet përkatëse buxhetore ku përfituesit marrin pagën bruto në 35 000 lekë. Në fillim të procesit të përcaktimit të përfitueve dhe sa herë që ndryshojnë kushtet për përfitim, personat përfitues të këtij kompensimi së bashku me deklaratën personale duhet të paraqesin pranë strukturës përkatëse të burimeve njerëzore dokumentacionin e kërkuar.

2. Institucionet buxhetore për punonjësit në institucionet buxhetore japin dhe përballojnë kompensimin për punonjësit e tyre dhe i përballojnë nga fondet buxhetore të miratuara për institucionet e tyre...”

IV. Arsyetimi ligjor

Në përfundim të analizës së legjislacionit, rezultoi se:

VKM nr. nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”, në pikën 1/ç, të saj parashikon se:

“1. Kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj, për:

.....

c) familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë) mijë lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar...”

Akti i mësipërm nënligjor në fuqi⁶ për mbrojtjen e shtresave në nevojë për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj, parashikon kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë) mijë lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar.

Përfitimet që rrjedhin nga skemat e kompensimit të energjisë elektrike për mbrojtjen e shtresave në

⁶ Pika 1/ç, e VKM-së nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj”.

nevojë, janë mbi bazën e kërkesës dhe jo automatikisht të aplikueshme për kategoritë përfituese.

Nga analiza e aktit nënligjor, për çështjen objekt shqyrtimi, VKM-së nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”, vlerësohet se një nga kategoritë e shtresave në nevojë për përfitimin e kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, janë familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë) mijë lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar.

Komisioneri vëren se, *a prima facie*, parashikim i kësaj dispozite, vendos një diferencë në trajtim, midis familjeve të punonjësve buxhetorë, me pagë mujore bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar, dhe familjeve të cilat ndodhen në kushte të ngjashme, pra kanë të punësuar vetëm kryefamiljarin, me pagë mujore bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar, me ndryshimin e vetëm se, kryefamiljari, është i punësuar në sektorin privat.

Nisur nga sa më sipër, evidentohet se, nëse kategoria e familjeve të punonjësve buxhetorë, me pagë bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar, përfiton kompensim të energjisë elektrike për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh, sipas pikës 1/ç, të VKM nr. 8/2015; kategoria e familjeve të punonjësve të punësuar në sektorin privat, me të njëjtin nivel page dhe në të njëjtat kushte, ku i vetmi i punësuar i familjes është kryefamiljari, nuk përfiton nga skema e mbrojtjes së shtresave në nevojë, parashikuar nga VKM-ja sipërcituar.

Për rrjedhojë, dukshëm diferencimi që bëhet nga dispozita e analizuar, bazohet vetëm në faktin që familjet jo përfituese, ndodhur në të njëjtat kushte e rrethana faktike, kryefamiljarin e kanë punonjës buxhetorë dhe jo të punësuar në sektorin privat.

Parë në këtë këndvështrim, Komisioneri (*evidentojmë edhe faktin se nga ana e KM-së nuk u disponuan parashtrime apo objeksione lidhur me ndonjë shpjegim të arsyeshëm apo krietime objektive mbi bazën e të cilave mund të ishte bërë ky diferencim*), analizon trajtimin ligjor që u bëhet këtyre dy kategorive të punonjësve: buxhetorë dhe të punësuar në sektorin privat, në raport me të ardhurat mujore bruto të tyre, të cilat janë në të njëjtën shumë, prej 35 000 mijë lekësh në muaj dhe përbëjnë të ardhurat financiare familjare të vetme për familjet e tyre.

VKM nr. 113, date 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, në pikën 1, të tij parashikon se: “1. Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 40 000 (dyzet mijë) lekë⁷.”

⁷ Pagë bruto.

Në këtë këndvështrim, të ardhurat e punonjësit kryefamiljar, (qoftë buxhetor, qoftë i punësuar në sektorin privat), objekt hetimi i kësaj çështjeje, (në shumën prej 35 mijë lekësh në muaj) janë nën shumën e përcaktuar si pagë bazë minimale për të gjithë punonjësit në shkallë vendi.

Për rrjedhojë, bazuar në pagën mujore prej 35 mijë lekësh të kësaj kategorie punonjësish kryefamiljarë buxhetorë, të cilat përbëjnë edhe të ardhurat e vetme financiare për familjet e tyre, që është dhe nën pagën bazë minimale në shkallë vendi, legjislatori dhe qeveria shqiptare kanë parashkuar një sërë masash zbutëse, sikurse është parashikimi i bërë në pikën 1/ç, të VKM nr. 8/2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”, me qëllim kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike.

Parë në këtë prizëm, Komisioneri vlerëson se këto janë masa pozitive të ndërmarra, me qëllim ndihmesën e kësaj kategorie familjesh. Mirëpo, në kontekst të trajtimit të këtyre familjeve, të cilat të ardhurat e vetme të tyre i sigurojnë nga të ardhurat nga punësimi i kryefamiljarit, me pagë nën 35 mijë lekë në muaj, pra, me të ardhura të ulëta mujore, legjislatori, të gjitha këto familje i konsideron si *familje në nevojë*, apo *si klientë në nevojë*⁸ duke parashkuar edhe lehtësirat përkatëse, duke përfituar mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, bazuar pikërisht në statusin e tyre klientë me të ardhura të ulëta, të cilët përdorin energjinë elektrike për furnizimin e vendbanimit të tyre të përhershëm.

Legjislacioni që trajton familjet me të ardhura të ulëta financiare, përfshirë edhe legjislacionin përkatës për *klientin në nevojë*, nuk vendos kufizime lidhur me faktin nëse kryefamiljari me të ardhura mujore (pagë) nën 35 mijë lekë në muaj, është i punësuar në shtet, pra buxhetor, apo në sektorin privat, duke mos bërë asnjë diferencim përsa i takon punëdhënësit apo sektorit të punësimit të tyre (shtet apo privat).

Referuar parashikimit e të aktit nënligjor, objekt shqyrtimi, pikës 1/ç, të VKM nr. 8/2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”, kompensimin financiar për energjinë elektrike e përfitojnë familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar.

Pra, në rrafshin krahasues, nëse kryefamiljari është punonjës jo buxhetorë/i punësuar në sektorin privat, familja e tij, nuk përfiton kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike, sipas VKM-së 8/2015, duke bërë një diferencim në trajtim për shkak të faktit se ai është i punësuar në sektorin privat, pavarësisht faktit se ndodhen në të njëjtat kushte e rrethana, pra, kanë të dy pagë bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, janë punonjës kryefamiljarë dhe nuk kanë asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar.

⁸ Referuar nenit 95, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”

Referuar sa më sipër, rezulton se akti nënligjor në pamje të parë trajton në mënyrë të pabarabartë, familjet përfituese të kompensimit financiar për energjinë elektrike, bazuar vetëm në faktin se të ardhurat financiare të vetme të familjes, që vijnë nga paga mujore e kryefamiljarit të tyre, janë nga punësimi i tyre në shtet, dhe jo në sektorin privat.

Përjashtimi i kësaj kategorie familjesh (*të ardhur e vetme financiare të të cilave vijnë nga paga e kryefamiljarit të punësuar në sektorin privat*) nga e drejta e përfitimit të kompensimit të energjisë elektrike, pavarësisht faktit se janë familje me të ardhura të ulëta dhe konsiderohen si klientë në nevojë⁹, i privon ato, nga e drejta për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë me familjet me të njëjta të ardhura mujore (gjithashtu konsideruar si familje me të ardhura të ulëta dhe klientë në nevojë), kryefamiljari i të cilave është punonjës buxhetor, pra i punësuar në sektorin shtetëror.

Në bazë të ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, "*Diskriminim*" është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Në kuptim të LMD-së, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 3, të tij: "*Diskriminim i drejtpërdrejtë*" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji."

Sa më sipër rezulton se gëzimi dhe ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët i të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe çdo të drejta tjetër që buron nga ligjet në fuqi, garantohet duke eliminuar diskriminimin formal dhe atë substancial.

Diskriminimi mund të rezultojë jo vetëm nga trajtimi i ndryshëm i njerëzve në situata të njëjta (diskriminimi formal), por gjithashtu duke ofruar të njëjtin trajtim për njerëzit në situata të ndryshme (diskriminimi substancial).

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: "*Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta*", si dhe "*Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme*

⁹ Sipas legjislacionit për energjinë elektrike.

dhe objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se VKM nr. 08/2015, sipërcituar, e cila, rimbursimin e energjisë elektrike për kategoritë e familjeve përfituese, me të ardhura të vetme financiare familjare nga paga e kryefamiljarit buxhetor, me pagë mujore bruto nën 35 mijë lekë, e lidh me kriterin e të qenurit të kryefamiljarit punonjës buxhetor, duke përjashtuar në mënyrë kategorike familjet me të njëjta të ardhura financiare mujore, por me ndryshmin që këto të ardhura vijnë nga paga mujore e kryefamiljarit/punonjësi në sektorin privat, dhe jo buxhetor; vjen në kundërshtim me ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, pasi i vendos familjet me kryefamiljarë/punonjës në sektorin privat/jo buxhetorë, në pozita diskriminuuese, bazuar pikërisht në këtë shkak (klasifikimine tyre si punonjës të sektorit privat).

V. Konkluzione

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t’u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, si dhe mundësisht t’u garantohet jetesa e pavarur.

Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të individëve, duhet të sigurohet që t’i ofrojë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme.

Referuar parashikimeve specifike në legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria, legjislacionin e brendshëm, si dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare; barazia dhe mosdiskriminimi, duhet kuptuar jo vetëm si barazi formale, por ajo duhet të jetë e zbatueshme, efektive dhe e prekshme për këta persona.

Materializimi i shumë të drejtave për individët, bëhet fillimisht nëpërmjet hartimit dhe miratimit të ligjeve dhe akteve nënligjore nga ana e qeverisë, e mandej nëpërmjet zbatimit efektiv në praktikë të tyre.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor¹⁰.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është

¹⁰¹⁰ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14, do të krijojë detyrime positive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹¹. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹².

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në studimin e publikuar “*Mbrojtja e përmirësuar ndaj diskriminimit e konsumatorëve në nevojë përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator*”¹³, të vitit 2021, nisur nga gjetjet e këtij studimi, në mes të tjerash, ka theksuar se: “*Është thelbësore të tregohet kujdes i shtuar për grupet vulnerabël pasi vështirësitë e krijuara nga situata ekonomike, si dhe nga situata e pandemisë Covid 19 kanë ndikuar negativisht në zinxhirin e ekonomisë për punësim dhe të ardhurat duke rritur rrezikun e varfërisë së energjisë për këto konsumatorë vulnerabël. Njëkohësisht, sidomos në kohën e pandemisë por jo vetëm, familjet e pamundura për shkak të problemeve me energjinë si dhe ndërprejes së saj, rrezikohen në garantimin e të drejtës për arsim të fëmijëve të tyre. Në këtë mënyrë thellohen më shumë jo vetëm pabarazitë ekonomike por edhe diferencimet sociale dhe kulturore, si dhe shtohet pamundësia reale për mundësi të barabarta.*

....

Jetesa në një shtëpi që plotëson standardet minimale është një e drejte themelore, parashikuar dhe në Objektivat e OKB-së.

Familjet që përjetojnë varfëri energjetike kanë shfaqje të lartë të sëmundjeve fizike, probleme të shëndetit mendor dhe fizik.

¹¹ Shih: Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019

¹² Shih: Çështjen Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen Thlimmenos, cituar më lart, prg. 44; Çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

¹³ Mundësuar në kontekstin e Projektit: “*Mbështetje për forcimin e kapaciteteve institucionale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) në zbatimin e mandatit të tij për të mbrojtur nga diskriminimi gratë dhe burrat në Shqipëri*”, zbatuar nga KMD në bashkëpunim me UNDP me fonde të qeverisë Norvegjeze.

Një nga elementët kryesorë të studimit për përcaktimin e kërkesave minimale të furnizimit me energji elektrike të familjeve në nevojë është padyshim analiza dhe shqyrtimi i politikave dhe strategjive qeveritare për të mbështetur kategoritë e klienteve në nevojë, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të paguajnë faturën e energjisë elektrike.

Target grupi i intervistuar bazuar në të ardhurat e tyre financiare dhe shërbimet që ato marrin nga furnizimi me energji elektrike jeton në kushte ekstreme të dobëta ekonomike.

Komisioneri bazuar në gjetjet e këtij studimi, në mes të tjerash, në konkluzionet e rekomandimet e tij, ndër të tjera, citon se:

“Me gjithë kufizimet e tij studimi arriti të japë disa indikatorë mbi situatën social-ekonomike të shumë familjeve të pamundura dhe impaktit që energjia elektrike ushtron në situatën e tyre. Në funksion të gjetjeve në studim, konkludohet se energjia elektrike si një përbërës i rëndësishëm i mirëqenies së qytetarëve dhe gëzimit të të drejtave të tyre, është kusht i domosdoshëm për përfshirjen e grupeve më të pamundura të shoqërisë në jetën sociale, kulturore, ekonomike. E drejta për strehim të përshtatshëm dhe energji elektrike janë kushte për garantimin e disa të drejtave të tjera themelore si: e drejta e shëndetit fizik dhe mendor, e drejta për arsim, e drejta për tu informuar, e drejta për jetë familjare dhe private, e drejta për një jetë dinjitoze

Ndër rekomandimet e bëra në studim, ndër të tjera, janë edhe si vijon:

“...Paraprakisht, përfshirja e në përfitimin e kompensimit të të gjitha familjeve me të ardhura më të pakta se 35.000 Lekë në muaj dhe jo vetëm të punonjësve buxhetorë.

Statusi i klientit në nevojë të parashikojë lehtësira për vendosjen e aparateve të energjisë elektrike, sidomos për familjet që kanë të ardhura më të vogla se paga minimale në shkallë kombëtare;

Statusi i klientit në nevojë të parashikojë mundësinë e mbështjetjes totalisht nga shteti të pagesës deri në një nivel konsumi Kwh për familjet me të ardhura më të pakta se paga minimale në shkallë

kombëtare;

Statusi i klientit në nevojë të parashikojë mundësinë e çmimit më të ulët për Kwh për familjet që e përfitojnë këtë status;

Si kriter për përcaktimin e statusit të klientit në nevojë, në mënyrë gjithëpërfshirëse, duhet të shërbejë gjendja ekonomike dhe përcaktimi i një niveli të ardhurash maksimal për përfitimin e statusit;

Në funksion të kësaj, si konsumatorë përfitues të statusit të klientit në nevojë rekomandohet të jenë:

...

Familjet që kanë nivel të ardhurash më të vogël se tavani i të ardhurave i vendosur për përfitimin e statusit të klientit në nevojë”.

Komisioneri vlerëson se, shteti nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, duhet t'u sigurojë barazi në trajtim të gjithë familjeve me të ardhura të ulëta financiare mujore, të ardhurat e të cilave konsistojnë vetëm nga paga e kryefamiljarit të tyre dhe janë nën shumën e pagës minimale të caktuar në rang kombëtar, në mënyrë që ata të përfitojnë nga skemat e mbrojtjes sociale; pavarësisht faktin nëse janë kryefamiljarët e tyre, janë punonjës buxhetorë apo të punësuar në sektorin privat.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur shteti, krijon skema të caktuara të mbrojtjes sociale, duhet që ta sigurojë atë dhe ta ofrojë mbështetjen financiare pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme.

Bazuar në sa më lart, Komisioneri gjykon se, me qëllim eliminimin e situatës diskriminuese për familjet me të ardhura mujore më të ulëta se 35 mijë lekë në muaj, është e nevojshme që të rishikohet akti nënligjor, objekt i kësaj çështje, duke përcaktuar përfitimin e kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për të gjitha familjet me të ardhura financiare mujore nën pragun e shumë 35 mijë lekë në muaj, pavarësisht faktit se këto të ardhura vijnë nga punësimi i kryefamiljarit në sektorin shtetëror apo atë privat.

Referuar VKM-së nr. 609, datë 20.10.2021 *“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”* ku përcaktohet se MSHMS, ndër të tjera, është përgjegjëse për zhvillimin e politikave që synojnë mbrojtjen, promovimin, integrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë, del qartë fusha e përgjegjësisë e MSHMS, për marrjen e iniciativës për ndryshimin e aktit nënligjor, objekt i këtij rekomandimi.

Po ashtu, referuar VKM-së nr. 8/2015 *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike, deri në 300 Kwh në muaj”*, evidentohet se MSHMS, Ministria e Energjisë dhe Industrisë/MEI, Ministria e Financave dhe Ekonomisë/MFE, ndër të tjera, janë struktura bashkërenduese për marrjen e iniciativës për propozimin e aktit nënligjor, objekt i këtij rekomandimi, e logjikisht edhe për ndryshimin e tij.

Sa më sipër, me qëllim rregullimin e situatës, si dhe bazuar në nenin 32, pika 1, shkronjën “f”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

REKOMANDON:

1. Marrjen e masave të të gjitha strukturave përgjegjëse, sipas fushë së kompetencës së tyre, për rishikimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 8/2015 *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike, deri në 300 Kwh në muaj”*, duke përcaktuar përfitimin e kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë

elektrike, për të gjitha familjet me të ardhura më të ulëta se 35.000 lekë në muaj dhe jo vetëm të familjeve me kryefamiljarë, punonjës buxhetorë.

2. Lutemi brenda 30 ditëve nga marrja dijani, përcjelljen e informacionit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi apo çdo informacion tjetër që ka rëndësi lidhur me këtë çështje.

KOMISIONERI

Robert GAJDA